



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 748/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.11.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për mënyrën e shqyrtimit, vlerësimit të ofertave, zhvillimin e procedurës së prokurimit, si dhe mënyrën e kualifikimit të ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “R.S. & M” sh.p.k. & “Inerti” sh.p.k. & “Ave Consulting” sh.pk. & “Taulant” sh.p.k. si oferta ekonomike më e mirë në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF- 34136-08-22-2019, me objekt “*Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës Vertikale/Horizontale në akset Kombëtare dhe përmirësimi i sigorisë rrugore në akset e Jugut (loti 3) vazhdimi*”, me fond limit 166.278.127,41 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 24.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar”.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “R.S. & M” sh.p.k. & “Inerti” sh.p.k. & “Ave Consulting” sh.pk. & “Taulant” sh.p.k.
Autostrada Tiranë – Durrës, Km 2, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Rrugor Shqiptar
Rruga “Sami Frashëri”, nr. 33, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.08.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-34136-08-22-2019, me objekt “Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës Vertikale/Horizontale në akset Kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore në akset e Jugut (loti 3) vazhdimi”, me fond limit 166.278.127,41 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 26.09.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “I.D.K. Konstruksion” sh.p.k.
& “Erald” sh.p.k. 129.696.939,38 lekë, kualifikuar
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “R.S. & M” sh.p.k. & “Inerti” sh.p.k.
& “Ave Consulting” sh.p.k. & “Taulant” sh.p.k. 166.277.470,5 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 26.09.2019 bashkimi i operatorëve ekonomikë “R.S. & M” sh.p.k. & “Inerti” sh.p.k. & “Ave Consulting” sh.p.k. & “Taulant” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4. Në datën 03.10.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton zhvillimin e procedurës së prokurimit përsa i përket mënyrës së vlerësimit të ofertave të paraqitura nga ana ekonomike e tyre.

Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon se:

Duke kuptuar që qëllimi i projektimit dhe i punimeve mbi tenderin me procedurë të hapur me objekt: “Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës Vertikale/Horizontale ne akset Kombëtare dhe përmirësim të sigorisë rrugore ne akset e Jugut, loti 3, vazhdimi “realizuar nga ARRSH” është rritja e sigorisë rrugore si pasojë duke ulur aksidentet në rrugë. Shoqëritë bashkëpunuese “R.S&M + Inerti + Ave Consulting+ Taulanti” sh.p.k kanë bërë një projektim dhe studim të akseve pjesë të punimeve të këtij tenderi për barriera mbrojtëse, Sinjalistikë horizontale (vijëzime) dhe Sinjalistikë vertikale.

Pas projektimit dhe studimit të kryer është ofertuar mbi nevoja reale të këtyre akseve, duke patur në kërkesë të lartë për rritjen e standartit të sigorisë rrugore në akset pjesë të kesaj gare, u vendosën elemente në vlerën korrekte për njësi.

Duke pasur në mend eksperiencën e gjatë të kompanive pjesë të këtij bashkëpunimi mbi projektimin dhe zbatimin në fushën e sinjalistikës rrugore, ne jemi të sigurt që kandidatët e tjerë ofertues kanë ofertuar nën vlerën tonë si pasojë e uljes së sasisë të zërave dhe punimeve, por në raportin Sasi/Vlerë jemi të sigurt që shoqëritë bashkëpunuese “R.S&M + Inerti + Ave Consulting + Taulanti” sh.p.k kanë vlerë më të ulët në këtë garë.

Sipas bindjes tonë KVO ka zgjedhur ofertën më të ulët pa analizuar punimet që do të kryhen realisht në këto akse dhe raportin Sasi/Vlerë të nevojshme për kryerjen e këtij projekti.

Bazuar në sa më sipër kërkojmë nga ana juaj rishqyrtimin e ofertave të kandidatëve ofertues duke pasur në mend raportin Sasi/Vlerë dhe pas shqyrtimit të ofertave në këtë formulë renditjen e bashkëpunimit “R.S&M + Inerti + Ave Consulting+ Taulanti” sh.p.k si oferta me e mire.

II.5. Në datën 08.10.2019, me shkresën nr. 8830/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar ankesën.

Konkretisht autoriteti kontraktor i kthen përgjigjen ankimuesit duke argumentuar si më poshtë:

Në kuadër të zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt: “Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës Vertikale/Horizontale ne akset Kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore ne akset e Jugut, loti 3, vazhdimi” në AK është paraqitur ankesa me nr. 8830 prot, datë 03.10.2019 nga BO “R.S&M + Inerti + Ave Consulting+ Taulanti” sh.p.k.

Në mbështetje të nenit 63 të Ligjit 9643 datë 20.11.2014 [...] Nenit 78 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 dhe Urdhërit Nr. 235, datë 07.10.2019 të Titullarit të AK-së është pezulluar procedura dhe është ngritur Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës. Rezulton se ankesa është paraqitur në përputhje me nenin 78 të rregullave të prokurimit public, pika 3 [...].

J.V “R.S&M + Inerti + Ave Consulting+ Taulanti” sh.p.k në lidhje me objektin e mësipërm të prokurimit, pretendon skualifikimin e shoqërive si më poshtë vijon:

Pretendimi i operatorit:

Duke kuptuar që qëllimi i projektimit dhe punimeve mbi tenderin me procedurë të hapur me objekt: “Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës Vertikale/Horizontale ne akset Kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore ne akset e Jugut, loti 3, vazhdimi” realizuar nga ARRSH është rritja e sigurisë rrugore si pasojë duke ulur aksidentet në rrugë. Shoqëritë bashkëpunuese “R.S&M + Inerti + Ave Consulting+ Taulanti” sh.p.k kanë bërë një projektim dhe studim të akseve pjesë të punimeve të këtij tenderi për barriera mbrojtëse, Sinjalistikë horizontale (vijëzime) dhe Sinjalistikë vertikale. Pas projektimit dhe studimit të kryer është ofertuar mbi nevoja reale të këtyre akseve, duke patur në kërkesë të lartë për rritjen e standartit të sigurisë rrugore në akset pjesë të kësaj gare, u vendosën element në vlerën korrekte për njësi.

Duke pasur në mend eksperiencën e gjatë të kompanive pjesë të këtij bashkëpunimi mbi projektimin dhe zbatimin në fushën e sinjalistikës rrugore, ne jemi të sigurt që kandidatët e tjerë ofertues kanë ofertuar nën vlerën tonë si pasojë e uljes së sasisë të zërave dhe punimeve, por në raportin Sasi/Vlerë jemi të sigurt që shoqëritë bashkëpunuese “R.S&M + Inerti + Ave Consulting + Taulanti” sh.p.k kanë vlerë më të ulët në këtë garë.

Sipas bindej tonë KVO ka zgjedhur ofrtën më të ulët pa analizuar punimet që do të kryhen realisht në këto akse dhe raportin Sasi/Vlerë të nevojshme për kryerjen e këtij projekti.

Bazuar në sa më sipër kërkojmë nga ana juaj rishqyrtimin e ofertave të kandidatëve ofertues duke pasur në mend raportin Sasi/Vlerë dhe pas shqyrtimit të ofertave në këtë formulë renditjen e bashkëpunimit “R.S&M + Inerti + Ave Consulting+ Taulanti” sh.p.k si oferta më e mirë.

Argumentimi I KSHA-së:

Ankimuesi kërkon rishqyrtimin e ofertave dhe kualifikimin e ofertës së tyre si oferta ekonomike më e mirë , pasi pretendon se ofertuesit e tjerë kanë ofertuar nën vlerën e tyre si pasojë e uljes së sasisë së zërave dhe punimeve. Sqarojmë se preventive në lidhje me këtë projekt është paraprak. Vëllimet e parshikuara janë të përafërta. Projekti i plotë i zbatimit da të bëhet nga Kontraktori dhe miratohet nga AK pas nënshkrimit të kontratës.

Referuar VKM Nr.914, datë 29.12.2014 , Neni 26 [...], kjo kontratë do të trajtohet si një kontratë me çelësa në dorë, ku vëllimi i punëve të parashikuara në këtë project, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit.

Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, pëveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi. Për këtë procedurë, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave është bërë konform Nenit 66 të VKM-së Nr.914 datë 29.12.2014 [...] dhe janë kualifikaur vetëm oferta, të cilat kanë përmbushur kriteret

për kualifikim, të përcaktuar në dokumentat standarte të tendrit, si dhe është spallur fitues OE që ka patur vlerën e ofertës, çmimin më të ulët.

Për këto arsye, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

II.6. Në datën 17.10.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur pretendimin për zhvillimin e procedurës, mënyrën e vlerësimit të ofertave dhe kualifikimin e ofertave më të mira ekonomike.

Konkretisht në ankesën e paraqitur pranë KPP-së operatori ekonomik ankimues argumenton:

Duke kuptuar që qëllimi i projektimit dhe i punimeve mbi tenderin me procedurë të hapur me objekt: “Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës Vertikale/Horizontale ne akset Kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore ne akset e Jugut, loti 3, vazhdimi” realizuar nga ARRSH” është rritja e sigurisë rrugore si pasojë duke ulur aksidentet në rrugë. Shoqëritë bashkëpunuese “R.S&M + Inerti + Ave Consulting+ Taulanti” sh.p.k kanë bërë një projektim dhe studim të akseve pjesë të punimeve të këtij tenderi për barriera mbrojtëse, Sinjalistikë horizontale (vijëzime) dhe Sinjalistikë vertikale.

Në ndryshim nga tenderat e tjerë, procedura e ndjekur nga autoriteti tenderues ishin në formatin me çelësa në dorë (lump sum), projektim dhe zbatim. Sipas kësaj procedure është tenderuar një fond ipërcaktuar për një segment rrugor dhe shoqëritë pjesëmarrëse ne tender duhej të ofronin projektin për këtë segment, punët që do të kryheshin, materialet e përdurura si dhe afatin kohor të realizimit të këtij projekti.

Nga ana e bashkimit të shoqërive “R.S&M + Inerti + Ave Consulting+ Taulanti” sh.p.k pas studimit të këtij segmenti u paraqit oferta, materialet që do të përdoreshin me sasi të dhe çmimet përkatëse, punimet që do të kryheshin si dhe aftate kohore të realizimit të tyre duke qëndruar Brenda fondit të tenderuar.

Duam të theksojmë faktin që projektimi dhe studimi i kryer është ofertuar mbi nevoja reale të këtyre akseve, duke pasur një kërkesë të lartë për rritjen e standartit të sigurisë rrugore në akset pjesë të kësaj gare, u vendosën elemente në vlerën korrekte për njësi. Pasi nuk mund të ketë një ofertë pa specifikuar sasinë dhe çmimin për njësi që do të investohet. AK si investitor në këtë projekt aprovon projektin si rrjedhim edhe preventivin duke saktësuar sasinë dhe çmimin/njësi ku del vlera reale e këtij projekti. Në përfundimin e procedurave të tenderimit jemi njoftuar që shoqëria jonë nuk është shpallur fituese e kësaj gare.

Duke pasur parasysh eksperiencën e gjatë të kompanive pjesë të këtij bashkëpunimi mbi projektimin dhe zbatimin në fushën e sinjalistikës rrugore, ne jemi të sigurt që kandidatët e tjetër ofertues kanë ofertuar nën vlerën tonë si pasojë e uljes së sasisë të zërave dhe punimeve, por në raportin Sasi/Vlerë jemi të sigurt që shoqëritë bashkëpunuese “R.S&M + Inerti + Ave Consulting + Taulanti” sh.p.k kanë vlerë më të ulët në këtë garë.

Pra thënë më qartë jemi të bindur që nga ana e KVO-së nuk janë marrë parasysh dhe nuk janë realizuar sasia dhe lloji i punimeve të ofruara nga shoqëria jonë dhe të bëhej krahasimi i tyre me të njëjta zëra të ofruara nga konkuresit e tjerë, por thjeshtë është bërë një zgjedhje mekanike e ofertës më të ulët. Kjo përzgjedhje ashtu siç e kemi sqaruar edhe më sipër nu është korrekte, pasi nuk janë përdorur baza të njëjta krahasimore. Do të ishte e udhës që të bëhej krahasimi I ofertave dhe çmimeve të ofruara për të njëjtat sasi dhe volum për të gjitha shoqëritë tenderuse dhe më pas të bëhej edhe vlerësimi I punimeve dhe materialeve shtesë që ofron çdo shoqëri.

Në përfundim autoriteti tenderues do të përzgjedhë nëse punimet dhe materialet shtesë të ofruara nga një apo disa prej ofertuesve dhe që janë brenda fondit limit të tenderuar do të jenë të nevojshme dhe nëse duhet apo jo të përfshihen në kontratën finale. Thënë më qartë nëse një shoqëri ka ofruar psh barriera mbrojtëse për një gjatësi prej 26 km sasinë prej 1000 ml me një çmim 3.500 lekë për ml dhe një vlerë totale 3.500.000 lekë, ndërkohë që një shoqëri tjetër ka ofruar 800 ml barrier mbrojtëse për të njëjtin segment me çmim 3.600 lekë për ml me një vlerë totale prej 2.880.000 lekësh kjo nuk do të thotë që oferta më e mirë është ajo e shoqërisë së dytë, pasi nëse do të bëhej krahasimi I njëjtë dhe shoqëria e parë do të sjelli 800 ml me çmim 3.550.000 lekë atëherë vlera totale do të jetë 2.880.000 lekë, pra më e ulët se shoqëria e dytë. Ky është thelbi i vlerësimit të ofertave në rastin e kontratave lump sum të përdorura këtë herë nga ana e autoritetit tenderuas, që do të thotë krahasimi i punimeve që do të kryhen realisht në këto akse dhe raportin Sasi/Vlerë të nevojshme për kryerjen e këtij projekti.

Bazuar në sa më sipër kërkojmë nga ana juaj rishqyrtimin e ofertave të kandidatëve ofertues duke pasur ndërmend Raportin Sasi/Vlerë dhe më pas shqyrtimin e ofertave në këtë formulë.

II.7. Në datën 28.10.2019, nëpërmjet shkresës me nr. 9742/1 prot., datë 25.10.2019, me objekt: “Informacion mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Përmirësimi rifreskimi i sinjalistikës Vertikale/Horizontale në akset Kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore në akset e jugut (loti 3) vazhdimi”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: [...] Në përfundimin e procedurave të tenderimit jemi njoftuar që shoqëria jonë nuk është shpallur fituese e kësaj gare. Duke pasur parasysh eksperiencën e gjatë të kompanive pjesë të këtij bashkëpunimi mbi projektimin dhe zbatimin në fushën e sinjalistikës rrugore, ne jemi të sigurt që kandidatët e tjetër ofertues kanë ofertuar nën vlerën tonë si pasojë e uljes së sasisë të zërave dhe punimeve, por në raportin Sasi/Vlerë jemi të sigurt që shoqëritë bashkëpunuese “R.S&M + Inerti + Ave Consulting + Taulanti” sh.p.k kanë vlerë më të ulët në këtë garë. Pra thënë më qartë jemi të bindur që nga ana e KVO-së nuk janë marrë parasysh dhe nuk janë realizuar sasia dhe lloji i punimeve të ofruara nga shoqëria jonë dhe të bëhej krahasimi i tyre me të njëjta zëra të ofruara nga konkuresit e tjerë, por thjeshtë është bërë një zgjedhje mekanike e ofertës më të ulët. Kjo përzgjedhje ashtu siç e kemi sqaruar edhe më sipër nuk është korrekte, pasi nuk janë përdorur baza të njëjta krahasimore. Do të ishte e udhës që të bëhej krahasimi i ofertave dhe çmimeve të ofruara për të njëjtat sasi dhe volum për të gjitha shoqëritë tenderuse dhe më pas të bëhej edhe vlerësimi i punimeve dhe materialeve shtesë që ofron çdo shoqëri.

Në përfundim autoriteti tenderues do të përzgjedhë nëse punimet dhe materialet shtesë të ofruara nga një apo disa prej ofertuesve dhe që janë brenda fondit limit të tenderuar do të jenë të nevojshme dhe nëse duhet apo jo të përfshihen në kontratën finale. Thënë më qartë nëse një shoqëri ka ofruar psh barriera mbrojtëse për një gjatësi prej 26 km sasinë prej 1000 ml me një çmim 3.500 lekë për ml dhe një vlerë totale 3.500.000 lekë, ndërkohë që një shoqëri tjetër ka ofruar 800 ml barrier mbrojtëse për të njëjtin segment me çmim 3.600 lekë për ml me një vlerë totale prej 2.880.000 lekësh kjo nuk do të thotë që oferta më e mirë është ajo e shoqërisë së dytë, pasi nëse do të bëhej krahasimi i njëjtë dhe shoqëria e parë do të sjelli 800 ml me çmim 3.550.000 lekë atëherë vlera totale do të jetë 2.880.000 lekë, pra më e ulët se shoqëria e dytë.

Ky është thelbi i vlerësimit të ofertave në rastin e kontratave lump sum të përdorura këtë herë nga ana e autoritetit tenderues, që do të thotë krahasimi i punimeve që do të kryhen realisht në këto akse dhe raportin Sasi/Vlerë të nevojshme për kryerjen e këtij projekti.

Bazuar në sa më sipër kërkojmë nga ana juaj rishqyrtimin e ofertave të kandidatëve ofertues duke pasur ndërmend Raportin Sasi/Vlerë dhe më pas shqyrtimin e ofertave në këtë formulë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Seksioni 4 Procedura, pika 4.2. nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

4.2 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) **çmimi më i ulët** ☒ **X**

Ose

B) ☐ **oferta ekonomikisht më e favorshme** ☐

lidhur me rëndësinë: Çmimi ☐☐☐ **pikë**
etj. ☐☐ **pikë**

Autoriteti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për çdo kriter vlerësimi të vendosur.

III.1.2. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 14 nga autoriteti kontraktor është përcaktuar: **“Shenim:** Preventivi ne lidhje me kete projekt eshte paraprak. Vellimet e parashikuara jane te peraferta. Projekti i plote i zbatimit do te behet nga kontraktori dhe miratohet nga AK pas nenshkrimit kontrates. Pra referuar VKM Nr. 914 date 29.12.14 “Rregullat e Prokurimit Publik”, e ndryshuar, nenit 26 “Kontrata per Pune Publike”, pika b, kjo kontrate do te trajtohet si nje kontratë me çelësa në dorë, ku vëllimi i punëve i parashikuar në projekt, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit.

Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi”.

III.1.3. Gjithashtu në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar nga ana e autoritetit kontraktor edhe dokumenti me emërtimin “Prev. prokurime (pa çmime) jugu sinjalistika”, në të cilin janë përcaktuar zërat si më poshtë:

PREVENTIVAT PARAPRAKË “ PËRMIRËSIMI RIFRESKIMI I SINJALISTIKËS VERTIKALE/HORIZONTALE NE AKSET KOMBËTARE DHE PËRMIRËSIMI I SIGURISË RRUIGORE NË AKSET E JUGUT (LOTI 3) VAZHDIIMI”						
Nr.	Segmentet rrugorë	km	Barrierat mbrojtëse/lekë	Vijëzimet/lekë	Sinjalistika vertikale/lekë	Shuma (leke)
1	Segmenti rrugor Levan - Vlore	26				
2	Segmenti rrugor K/Pojan - Apolloni	5				
3	Segmenti rrugor Jeta e Re - Kosovë	7				
4	Segmenti rrugor Leskovik - Sarandopor (Dog)	13				
5	Segmenti rrugor Erseke - Leskovik	43.6				
6	Segmenti rrugor Libonik - Lozhan	16.2				
7	Segmenti rrugor Berat - Çorovode	49.3				
		143.9				
TOTALI						
FONDI REZERVE 3%						
A. KOSTO E NDERTIMIT ME FONDIN REZERVE						
B. KOSTO E PROJEKTIT TE ZBATIMIT						
STUDIMI TOPOGRAFIK I						
PROJEKTI I ZBATIMIT II						
B. SHUMA I + II						
SHUMA A + B (NDERTIM + PROJEKTIM)						
TVSH 20%						
VLERA TOTALE						

SHENIM:

Preventivi në lidhje me këtë projekt është paraprak. Vëllimet e parashikuara janë të përafërta. Projekti i plotë i zbatimit do të bëhet nga Kontraktori dhe miratohet nga AK pas nënshkrimit të kontratës. Pra referuar VKM-së Nr.914 datë 29.12.2014 Rregullat e Prokurimit Publik, e ndryshuar kjo kontratë do të trajtohet si një "kontratë me çelësa në dorë, ku vëllimi i punimeve i parashikuar në projekt, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punimeve të projektit. Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi".

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

III.1.5. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.1.6. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një ndër parimet kryesore të përzgjedhjes referuar edhe nenit 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar është edhe mosdiskriminimi dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.8. Nga sa më sipër, referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se, ky i fundit, rezulton të jetë i kualifikuar nga autoriteti kontraktor por që nga vlera e ofertës ekonomike është renditur i dyti.

Operatori ekonomik ankimues, në ankesën e paraqitur ngre pretendime në lidhje me shqyrtimin dhe vlerësimin e procedurës, e cila, sipas pretendimit të tij, ka ardhur si rrjedhojë e hartimit gabim të dokumentave të tenderit të kësaj procedure prokurimi. Lidhur me këtë pretendim, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se operatori ekonomik ankimues në këtë fazë nuk legjitimohet të paraqesë pretendime përsa i përket dokumentave të tenderit dhe mënyrës së hartimit të tyre nga ana e autoritetit kontraktor. Referuar këtij fakti, sqarojmë se në legjislacionin për prokurimin publik janë përcaktuar më së miri, rastet se, kur një operator ekonomik është i paqartë apo ka pretendime në lidhje me hartimin e dokumentave të tenderit, ai mund të përdorë mjetin ligjor të ankimimit.

KPP, gjykon se, në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me hartimin e dokumentave të tenderit si edhe mënyrën e zhvillimit të saj (vlerësimin), ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se:

“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

III.1.9. Në rastin konkret, përveç faktit se ankesa e paraqitur është një ankesë e përgjithshme mbi mënyrën e zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, për më tepër kur ky pretendim lidhet me mënyrën e vlerësimin të saj, është një ankesë e cila nuk pasqyron pretendimin konkret të operatorit ekonomik ankimues në lidhje me procesin e vlerësimin të ofertave.

Sqarojmë se, vlerësimi i ofertave, nisur nga pretendimi i ankimuesit që pretendon se oferta e tij duhet të vlerësohet si oferta më e mirë ekonomike, është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, ku konkretisht është përcaktuar se kriteret e përzgjedhjes së fituesit do të bëhen duke u përzgjedhur çmimi më i ulët, ashtu siç edhe autoriteti kontraktor ka vepruar në këtë rast, duke bërë vlerësimin mbi bazën e dokumentacionit të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike.

Operatori ekonomik në momentin që ka marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi ka qenë dakord me këto dokumenta tenderi dhe nuk ka paraqitur asnjë ankim në lidhje me hartimin e tyre apo përcaktimin e kriterëve të saj.

III.1.10. Autoriteti kontraktor në informacionin dhe dokumentacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik sqaron se:

Sqarojmë se preventivi në lidhje me këtë projekt është paraprak. Vëllimet e parshikuara janë të përafërta. Projekti i plotë i zbatimit do të bëhet nga Kontraktori dhe miratohet nga AK pas nënshkrimit të kontratës.

Referuar VKM Nr.914, datë 29.12.2014 , Neni 26 [...], kjo kontratë do të trajtohet si një kontratë me çelësa në dorë, ku vëllimi i punëve të parashikuara në këtë projekt, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit. Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi. Për këtë procedurë, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave është bërë konform Nenit 66 të VKM-së Nr.914 datë 29.12.2014 [...] dhe janë kualifikuar vetëm oferta, të cilat kanë përmbushur kriteret për kualifikim, të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit, si dhe është spallur fitues OE që ka patur vlerën e ofertës, çmimin më të ulët”, sqarim dhe informacion ky, i cili është publikuar, në sistemin e prokurimeve elektronike dhe i është bërë e njohur të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar që në publikimin e kësaj procedure prokurimi.

III.1.11. Nga ana tjetër, nga verifikimi i ofertave ekonomike të paraqitura nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë, konstatohet se ato janë paraqitur në përputhje me preventivin dhe zërat e preventivit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në nenin 55, pika 2 të LPP-së parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit”.*

Komisioni i Prokurimit Publik thekson pozitën e tij të veçantë si një organ quazi gjyqësor dhe si i tillë në vendimarrjen e tij bazohet në fakt, prova dhe ligj. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse.

Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-së, i cili parashikon se *“Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit”*, por cënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 2 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Në rastin konkret, KPP konstaton se, referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në asnjë rast, se oferta fituese do të jetë ajo ekonomikisht më e mirë apo e favorshme, por ka përcaktuar që kriter përzgjedhje do të jetë çmimi më i ulët, kriter ky me të cilin të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar janë njohur që me publikimin e dokumentave të tenderit në sistemin e prokurimeve elektronike.

KPP gjykon se në cilësinë e një organi quasi gjyqësor, në vendimarrjen e tij, ky i fundit i referohet parimeve të së drejtës *Judicis est judicare secundum allegata et probate* (organi vendos në bazë të fakteve dhe provave të administruara në proces). KPP nuk mund të gjykojë mbi kritere të cilat nuk janë parashikuar shprehimisht në dokumentet e tenderit.

III.1.12. Akoma më tej, konstatohet se operatori ekonomik ankimues është i kualifikuar dhe renditet i dyti për nga oferta ekonomike, pra është një operator tjetër ekonomik i renditur i pari dhe që është i kualifikuar e me ofertë ekonomike më të ulët se ankimuesi.

III.1.13. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, *“Të drejtat e personit të interesuar”* parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.1.14. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Në klasifikimin e dhënë nga vlerësimi i KVO-së konstatohet se, në këtë procedurë prokurimi janë kualifikuar 2 (dy) operatorë ekonomikë, nga ku rezulton se operatori ekonomik ankimues është renditur në vendin e dytë.

Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Duke analizuar rastin në shqyrtim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk legjitimohet pasi, interesi i tij i ligjshëm, nuk ka sesi të dëmtohet, sepse, rezulton se ka të tjerë operatorë ekonomikë të kualifikuar të renditur me ofertë me vlerë më të ulët, për të cilët nuk ka ngritur pretendime, e si rrjedhim, kjo gjë nuk sjell ndonjë interes në favor të tij, ndërkohë që pretendimet e operatorit ekonomik ankimues lidhen vetëm për mënyrën e zhvillimit të procedurës dhe konkretisht mënyrës së shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave duke kundërshtuar njëkohësisht edhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në fazën e hapjes së ofertave, në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik në fuqi, pasi këto janë pretendime që i përkasin një faze tjetër konkretisht asaj të hartimit të dokumentave të tenderit që në momentin e publikimit të tyre siç më sipër analizuar.

KPP vlerëson se ankimuesi do të legjitimohej në interesin e tij, në qoftë se bashkë me ankimin e tij për procedurën, do të bashkëngjiste edhe ankim për operatorët e tjerë të kualifikuar të renditur me ofertë me vlerë më të ulët, çka rrjedhimisht bën që pretendimi i operatorit ekonomik ankimues të mos legjitimohet.

Sa më sipër analizuar, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “R.S. & M” sh.p.k. & “Inerti” sh.p.k. & “Ave Consulting” sh.pk. & “Taulant” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF- 34136-08-22-2019, me objekt “*Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës Vertikale/Horizontale në akset Kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore në akset e Jugut (loti 3) vazhdimi*”, me fond limit 166.278.127,41 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 24.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën përkatëse për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1634 Protokolli

Datë 17.10.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha